



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
POSTA SHQIPTARE SH.A
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1039/prot.
3

Tiranë, më 2.7.2025

FTESË PËR DHËNIE AMBIENTI ME QIRA

Në zbatim të Vendim Nr.141, datë 13.3.2018 Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr.54, datë 05.02.2014 “Për Përcaktimin e Kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar, dhe në zbatim të Urdhërit të Brendshëm Nr.37 datë 29.05.2025, Kërkesës me Nr. 1039 Prot. Datë 29.05.2025 me lëndë “Kërkesë për dhënie me qira të ambienteve Bar-Mencë në katin e parë të godinës së Drejtorisë së Përgjithshme “Posta Shqiptare” sh.a.”

Të dhënat për objektin: Ambienti ndodhet në godinën e Drejtorisë së Përgjithshme të “Posta Shqiptare” sh.a., në katin përdhe, dera e parë djathtas përballë hollit. Pasuria nr. 6/138, në zonën kadastrale 8380, indeksi i hartës TR-P-11, me sipërfaqe 66.1 m² me adresë Rr. “Reshit Çollaku”, Nr.4, Kodi Postar 1001 Tiranë.

Pajisjet: Ambienti është i mobiluar me 18 copë tavolina për lokal, 72 karrige lokali, banak bari+ekspozitor 4.6 metra linear dhe kontrabanak +frigorifer 4.6 metra linear.

1. Veprimtaria që do të ushtrohet – Bar-Mencë për punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme “Posta Shqiptare” sh.a
2. Kohëzgjatja e kontratës për dhënie me qira të ambientit të jetë 1 (një) vit.

Adresa: Rr. “Reshit Çollaku”, Nr. 4, Tiranë, Tel: 042222315, Kodi Postar 1001, www.postashqiptare.al

Faqe 1 nga 3

3. Oferta e detyrimit mujor të qirasë duhet të jetë konform përcaktimeve të Aneksit A “Tarifat Dysheme të qirasë mujore për ndërtesat sipas qarqeve” (Ndryshuar me VKM nr.992, datë 09.12.2015) si dhe Kreu III-të VKM nr. 54, dt. 05.02.2014 pika 5.

Ofertat e paraqitura nuk duhet të jenë më pak se vlera dysheme e llogaritur sipas përcaktimeve të ligjit të sipërcituar.

4. Dokumentacioni që duhet të paraqitet nga konkurrentët për konkurrim:

- a) Kërkesën e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore, ku të deklarohej oferta për vlerën e detyrimit mujor të qirasë, qëllimi i marrjes në përdorim të pronës shtetërore, si dhe treguesit e konkurrencës, të parashikuar sipas planit të biznesit;
- b) Planbiznesin e hollësishëm për vënien në funksionim të objektit, në të cilin duhet të përfshihet informacioni i mëposhtëm:
- Identiteti i subjektit kërkues, historiku i aktivitetit që kryen;
 - Përshkrimi i projektit të investimit, i punimeve që do të realizohen, i shërbimeve që do të ofrohen, i burimeve financiare të investimit;
 - Analiza e detajuar e afateve kohore, që do të duhen për të realizuar projektin investues, si dhe fazat e përcaktuara të realizimit të tij;
 - Niveli i punësimit, që do të realizohet sipas fazave kohore të përcaktuara.
- c) Deklaratat në formën e vetëdeklarimit, si më poshtë vijon:
- Deklaratë për të dhënat e NIPT/NUIS të subjektit kërkues;
 - Deklaratë për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe sigurimet shoqërore;
 - Deklaratë për administratorin dhe subjektin juridik ofertues, nëse është në ndjekje penale, si dhe nëse ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin;
 - Në rastet kur subjekti konkurrues zhvillon aktivitet me qira ose enfiteozë në objekte, pronë shtetërore, deklaratë për shlyerjen e detyrimeve, në të kundërt, të theksojë se nuk ushtron aktivitet në objekte shtetërore;
 - Deklaratë se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e dorëzuar në konkurrim. Në rast konstatimi të të dhënave të rreme, në çdo rast, komisioni e skualifikon subjektin konkurrues.



- ç) Ofertën për vlerën e detyrimit mujor të qirasë;
- d) Certifikatën e regjistrimit dhe certifikatën historike të regjistrimit të subjektit në QKR;
- dh) NUIS-in dhe vërtetimin nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore;
- e) Vërtetime nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin.

Ky dokumentacion duhet të plotësohet edhe në rastet kur objekti jepet me qira pa konkurrim.

- 5. Data e zhvillimit të procedurës : Datë 11.07.2025 Ora 11:00 Drejtoria e Përgjithshme e Posta Shqiptare sh.a, Kati I-rë, pranë recepsionit.
- 6. Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre janë të ftuar të ndjekin hapjen e ofertave.
- 7. Mosplotësimi i një kriteri për kualifikim përbën kusht për skualifikim.

